

FORUMI EKONOMIK I TIRANËS



Rritja ekonomike e vitit 2020 do të mbështet tek investimet dhe konsumi, dhe në sektorët kyç të ekonomisë, të cilët në vitin e kaluar kanë shënuar tregues pozitivë, përveç sektorit të energjisë elektrike për shkak të thatësisë. Gjatë pjesëmarrjes në Forumin Ekonomik të Tiranës, Ministria Denaj foli mbi pritshmëritë për rritjen ekonomike të vitit 2020, efektet që pritet të ketë Programi i Rindërtimit në rritjen ekonomike, përpjekjet e qeverisë në lehtësimin e të bërit biznes në vend dhe forcimin e dialogut me sipërmarrjen. Ministria tha se fundamentet kyç të ekonomisë paraqiten të qëndrueshëm, çka mbështet parashikimin e qeverisë për rritjen ekonomike të vitit 2020, ndërkohë që u shpreh optimiste në efektet pozitive që do të ketë aktiviteti i Rindërtimit në ekonomi.

VLERËSIMI I S&P



S&P konfirmon vlerësimin në "B+" dhe perspektivën "të qëndrueshme". Në rishikimin më të fundit të saj, agjencia ndërkombëtare e vlerësimit Standard & Poor's (S&P) konfirmon për Shqipërinë vlerësimin aktual në "B+" si dhe me perspektivë "të qëndrueshme". Ky vlerësim bazohet në pritshmëritë e S&P për një rritje të qëndrueshme ekonomike gjatë periudhës afat-mesme, vijimin e mbajtjes nën kontroll të deficitit buxhetor dhe uljes së borxhit publik. Vlerësimi pozitiv i S&P për ekonominë tonë e pozicionon Shqipërinë në hartën e investitorëve të huaj dhe konfirmon perspektivën e qëndrueshme afatmesme të vendit. Agjenda e reformave të qeverisë do të vazhdojë për të siguruar qëndrueshmëri ekonomike, përmirësim të jetës së qytetarëve dhe klimës së biznesit në vend.

MBLIDHET KËSHILLI I INVESTIMEVE



Ndërveprimi mes bashkive dhe biznesit në funksion të zhvillimit ekonomik, shërbimeve dhe transparencës ishte tema e mbledhjes së Këshillit të Investimeve. Diskutimet u përqendruan në çështje të lidhura me mirëadministrimin fiskal në nivel vendor, taksat dhe tarifat vendore, shërbimet e marra dhe rolin e Bashkive në zhvillimin ekonomik lokal. Ministria Denaj theksoi nevojën e rritjes së komunikimit dhe bashkëpunimit mes bashkive dhe biznesit, ndërsa vuri në dukje progresin e reformës administrative-territoriale; të ardhurat e pushtetit vendor nga burimet e veta vendore përfaqësojnë rreth 29.1% të burimeve financiare totale, ndërsa transfertat e pakushtëzuar e shpërndarë në vitin 2019 është 42% më e lartë se në vitin 2015 dhe rreth 38% më e lartë se niveli historik i saj.

LUFTA KUNDËR EVAZIONIT FISKAL



Kuvendi miratoi në seancë plenare projektligjin "Për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarive financiare", i cili i hap rrugë shkëmbimit të informacioneve mbi llogaritë "off shore" duke përfshirë bilancet e llogarive dhe ato të pronësisë. Kjo nismë ligjore cila vjen si detyrim i Shqipërisë për përaftrimin e legjislacionit me atë të BE-së, luftën kundër evazionit fiskal dhe parandalimin e pastrimit të parave. Ministria Denaj tha se sistemi i këmbimit automatik të informacionit do të rrisë të ardhurat, do të evitojë shmangien dhe evazionin fiskal, do të ofrojë kontroll më të mirë të marrëveshjeve të taksimit të dyfishtë, verifikim të të ardhurave të tatimpaguesve, etj.. Në tërësinë e tij, projektligji plotëson pritshmëritë në kuadër të taksimit në rrugëtimin drejt integritimit në BE.

AKTI NORMATIV I BUXHETIT 2019



Parlamenti miratoi në seancën e radhës Aktin Normativ të Buxhetit të vitit 2019, përmes të cilit u siguruan dy objektiva themelorë në kushtet e fundit të vitit 2019: masat e menjëhershme që qeveria ndërmori për të garantuar mundësitë financiare për përbalimin e situatës emergjente të krijuar pas tërmetit të datës 26 nëntor dhe akordimi i bonusit të përvitshëm për pensionistët në kuadër të paketës për solidaritetin. Në fjalën e saj, Ministria Denaj vuri në dukje se përmes Aktit Normativ u mundësua edhe fondi shtesë prej 1 miliardë lekësh për bonusin e qerave, i cili sot është zë buxhetor i hapur për tu përdorur nga pushteti lokal për banorët e prekur që kanë nevojë për këtë bonus.

ANALIZA VJETORE E MFE



Ministria Anila Denaj zhvilloi një takim me drejtuesit e 24 institucioneve të varësisë të MFE, në kuadër të ecurisë së performacës vjetore. Gjatë analizës u diskutuan arritjet e realizuara gjatë vitit 2019 dhe problematikat e hasura, të cilat kërkojnë zgjidhje administrative dhe/ose ndryshime ligjore. Në qendër të diskutimeve ishin edhe prioritetet për vitin 2020, ku ndër të tjera u theksua: realizimi i objektivave të parashikuara në planet vjetore të veprimit të çdo institucioni; intensifikimi i komunikimit ndërmjet institucioneve të varësisë dhe biznesin; procesi i deregulimit me fokus ofrimin e shërbimeve online. Ministria vlerësoi angazhimin për të realizuar objektivat e përcaktuara, ndërsa kërkoi intensifikim të përpjekjeve dhe rritje të bashkëpunimit ndërshtetërisht edhe për vitin 2020, me qëllim arritjen e një performace sa më pozitive.

PAKTI PËR UNIVERSITETIN



Ministria e Financave dhe Ekonomisë zhvilloi një forum diskutimi me brezin e parë të studentëve të ekselencës, të punësuar pranë MFE dhe institucionet e saj të varësisë. Diskutimet u fokusuan në sfidat e hasura gjatë rrugëtimit të studentëve të punësuar dhe të ardhmen e tyre në vijim të Paktit për Universitetin. Ministria Denaj u shpreh se studentët e ekselencës janë të rëndësishëm për të sjellë një frymë të re në administratën publike dhe MFE, duke vlerësuar këtë kontigjent të rinjsh, ka ofruar mbështetje përmes trajnimeve të nevojshme dhe një integrimi të plotë në vendin e punës. Përfundimi me sukses i testeve dhe përfshirja e tyre në shërbimin civil do të ishte përfundim dhe duhur e këtij rrugëtimi. Pranë MFE u punësuan rreth 175 studentë të ekselencës, nga 350 që u punësuan në administratën publike në tërësi.

PUNËSIMI PËRMES ZYRAVE TË PUNËS



1420 persona janë punësuar në gjithë vendin nëpërmjet ndërmjetësimit të zyrave të Punës gjatë periudhës 27 -31 Janar 2020. Numrin më të madh të të punësuarve e ka Qarku i Tiranës me 974 persona.